

2.6 PRODUKTE SHITESË PËR TRAJTIMIN E FUGAVE

D 707 ULTRACOLOR



Njësia matëse	copë/kuti	Ngjyra/specifikime të tjera
280 ml	12 cp/kuti	Transparent E bardhë Gri Bezhë Anemone Gri e lehtë



D 707 ULTRACOLOR

Silikon neutral me elasticitet.

KARAKTERISTIKAT

Silikon me elasticitet të madh, me ngjitshmëri të lartë në sipërfaqe poroze. Reziston ndaj mykut, kushtet e vështira kohore dhe rrezeve UV, dhe është rezistent ndaj detergjentëve, acidit dhe ujit të kripur. Stabilizohet shpejt duke reaguar më lagështinë, paraqet forcë ngjitëse të veçantë dhe rezistencë të gjatë në nyjet me levizshmëri të theksuar, pa u çarë dhe pa u rrjepur.

FUSHA E PËRDORIMIT

Silikoni D 707 Ultracolor përdoret pa astar në materiale siç janë porcelani, qelqi, qeramikë e emaluar, poliester, alumin i anoduar, dru të vernikuara për silikonim nyjesh me gjerësi 3 - 40mm, si për sipërfaqe të brendshme ashtu edhe për sipërfaqe të jashtme. Është i domosdoshëm për vulosjen e nyjeve në banaket e guzhinave, lavapjata inoxi, perimetrikisht në lavamane, vaska, pllaka dushi prej porcelani ose plastik, mjedise industriale ku nuk lejohet zhvillimi i kërpudhave. Rekomandohet për vulosje dhe montim konstruksionesh prej qelqi, por edhe zbatime të shumta hidraulike, ftohëse dhe elektrike, si edhe në montimin e pllakave.

MËNYRA E PËRDORIMIT

Përgatitja e sipërfaqes

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e thatë dhe e pastruar nga vajra dhe pluhura. Në qoftë se nevojitet astar, vendosja e silikonit bëhet të paktën pas 20 minutash dhe më të shumtën 3 orë. Për vendosje pa probleme pastrimi nga prapambetjet, rekomandohet përdorimi i shiritit të letrës ngjitëse para çdo përdorimi të silikonit, e cila hiqet pas çdo zbatimi.

APLIKIMI

Vendosim tubetin në pistoletën e posaçme dhe presim majën në mënyrë të pjerët, duke drejtuar majën në kënd 45° në drejtim të aksit të fugës, duke e mbushur pa bllokuar ajër. Lëmimi bëhet brenda 10 minutave me spatulë ose me gisht, pasi më parë të laget në ujë me detergjent.

KONSUMI

Fuga	Metra Lineare
4 x 6 mm	12,9
6 x 6 mm	8,6
8 x 6 mm	6,4
12 x 8 mm	3,2
16 x 10 mm	1,9
20 x 12 mm	1,3

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

Ruhet në mjedise të mbrojtura nga ngricat deri në 18 muaj nga data e prodhimit.

PAKETIMI

Kuti kartoni 6 tubetë 280 ml.

